



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



PAJISJET ELEKTRONIKE FISKALE KËRKESAT, KARAKTERISTIKAT FUNKSIONALE DHE TEKNIKE

**Prishtinë
Mars 2014**

Përmbajtja

Artikulli

faqe

KAPITULLI 1	9
<i>I Përgjithshëm</i>	9
ARTIKULLI 1	9
1.1 MF	9
1.2 ATK.....	9
ARTIKULLI 2	9
2.1 Korniza ligjore.....	9
2.2 Te drejtat e Administratës Tatimore të Kosovës	9
2.3 Qëllimi i këtij vendimi	9
2.4 Komisioni për licencimin e operatorëve ekonomik	9
ARTIKULLI 3	10
3.1 Autorizimi i modeleve të PEF dhe Terminaleve Tatimore për përdorim në Republikën e Kosovës .	10
3.2 Testimet për vërtetimin e përputhshmërisë me kërkesat Teknike dhe Funktionale.....	11
3.2.1 Për versionet e programit të një modeli të aprovuar bëhen vetëm testimet funksionale	11
3.2.2 Nëse pajisja fiskale e cila testohet ka pajisje ndërmjetësuese	11
3.2.3 Nëse pajisja fiskale e cila testohet ka ndërfaqe për tu lidhur me pajisjet tjera periferike	11
ARTIKULLI 4	11
Autorizimi i furnitorëve të sistemeve fiskale në Republikën e Kosovës:.....	11
ARTIKULLI 5	12
Përdorimi i obliguar i pajisjeve të aprovuara të furnizuar dhe instaluar nga furnitorët e licencuar	12
5.1 Procesi i obliguar që duhet përmbajtur para fillimit të përdorimit të PEF-ve dhe sistemeve fiskale	13
5.1.1 Forma e etiketës identifikuese në fillim të përdorimit	13
5.1.2 Instalimi i PEF-ve dhe sistemeve fiskale para fillimit të regjistrimit të transaksioneve.....	13
5.2 Kontrolli fillestar ai periodik dhe forma e etiketës së kontrollit periodik.....	13
5.2.1 Kontrolli periodik vjetor	13
5.2.2 Etiketa e kontrollit periodik vjetor	13
5.2.3 Dështimi i kryerjes së kontrollit periodik vjetor.....	14
5.3 Libreza speciale përcjellëse	15
ARTIKULLI 6	15

6.1	Kuponi Fiskal	15
ARTIKULLI 7.....		15
	Raporti Fiskal Ditor (RFD).....	15
	Modat Shtesë dhe raportet përkatëse të PEF-eve	16
7.1	Modi i leximit të raportit (X).....	16
7.2	Modi i Raportit Fiskal Ditor (RFD).....	16
7.3	Modi i programimit (P)	16
7.4	Modi i transferimit të përmbajtjes së memories fiskale	16
7.5	Të administrojë:	16
7.6	Programimi i datës dhe orës.....	17
7.7	Modet tjera	17
KAPITULLI 2		17
	<i>Kërkesat funksionale</i>	17
ARTIKULLI 8.....		17
8.1	Kërkesat e përgjithshme për PEF.....	17
8.2	Raportet	17
8.3	Siguria e të dhënave	18
8.4	Kontrolli nga zyrtaret tatimore	18
8.5	Mbushje e tepërt në modën e regjistrimit	18
8.6	Raportet periodike	18
8.7	Si sillen PEF kur furnizimi me rryme ndërpritet.....	18
8.8	Valuta e PEF-it.....	18
8.9	Shitja apo kthimi i një artikulli.....	18
8.10	Procedura e kthimit të artikullit të kthyer	19
8.11	Normat e TVSH-se	19
8.12	Data e PEF-it.....	19
8.13	Njehsoret e PEF-it	19
8.14	Formati i njehsorit të RFD-ve	19
8.15	Formati i njehsorit të dokumenteve të PEF-it	19

8.16	Sjellja e PEF-it ne rast gabimi.....	19
8.17	Raportet e PEF-it	20
8.18	Funksionet kontrolluese te PEF-it	20
8.19	Sjellja e PEF-it nëse mekanizmi i printimit është jashtë funksionit	20
8.20	Sjellja e PEF-it nëse memoria fiskale është e ç'kyçur	20
8.21	Furnizimi tjetër me rrymë elektrike.....	20
8.22	Printimi i të dhënave nga zyrtarët e autorizuar tatimor.....	20
8.23	Printimi i raportit fiskal ditor nëse nuk ka ndodhur asnjë transaksion.....	20
8.24	PEF i pajisur me një ditar elektronik.....	20
8.25	Parametri i shumë gjuhësisë.....	20
ARTIKULLI 9.....		21
Kërkesat për memorie fiskale.....		21
9.1	Moduli i veçantë	21
9.2	Kapaciteti i memories fiskale	21
9.3	Informatat qe regjistrohen në memorien fiskale para fillimit të punës	21
9.4	Të dhënat që ruhen në memorien fiskale	21
9.5	Nderprerja e funksionimit te memories operative	22
9.6	Struktura dhe kontrolli mbi informatat e regjistruara ne memorien fiskale	22
ARTIKULLI 10.....		22
Kërkesat e PEF për paraqitjen e të dhënave dhe printim.....		22
10.1	Mekanizmi i printimit	22
10.2	Format e ditarit elektronik	22
10.2.1	Ditari elektronik siguron hapësirë për më pak se 100 000 rreshta	22
10.2.2	Ditari elektronik siguron hapësirë më tepër se 100 000 rreshta	23
10.3	Limiti minimal i karaktereve ne nje dokument te printuar	24
10.4	Printimi i kuponit fiskal.....	24
10.5	Raporti Fiskal Ditor	25
10.6	Raporti i detajuar periodik	26
10.7	Raporti i shkurtë periodik	28
10.8	Raporti periodik qe transmetohet ne sistemin e ATK-së.....	28

10.9	Valuta e dokumentit	29
10.10	Kërkesat qe do t'iu përmbahet PEF-i.....	29
10.11	Printimi i të dhënave	30
10.11.1	Karakteristikat e letres termike per PEF-in dhe sistemin fiskal	30
10.11.2	Verifikimi i standardit te letres termike	30
ARTIKULLI 11.....		30
Kërkesat për Terminalin Tatimor (TT) për PEF-et e zakonshëm		30
11.1	Gadishmëria për te pranuar të dhënat	30
11.2	Transmetimi i te dhenave	30
11.3	Menyra e komunikimit	30
ARTIKULLI 12.....		32
Kërkesat Teknike Themelore		32
12.1	Tipi i memories fiskale te PEF-it.....	32
12.2	Kohëzgjatja e perdorimit aktiv tëPEF-it dhe TT	32
12.3	Ora e kohës reale	32
12.4	Sigurimi i të dhënave pa furnizim.....	32
12.5	Mekanizmi i printimit	32
12.6	Ekrani i operatorit dhe konsumatorit	32
12.7	Indikatorët e TT	32
12.8	Kapaciteti i memories per artikujt	32
12.9	Kushtet e punes se PEF-it	33
12.10	Montimi i memories fiskale	33
12.11	Mbyllja e PEF-it	33
12.12	Sigurimi i seteve te veçanta.....	33
12.13	Rexhistrat akumulativ	33
12.14	Ndertimi i PEF-it	33
12.15	Nderlidhja (interface) per lidhje me PC.....	33
12.16	Bateria Akumuluese	33
12.17	Tensioni alternativ furnizues.....	33
12.18	Kërkesat Teknike	34

ARTIKULLI 13.....	34
Sistemi fiskal për pika te shitjes në sektorë të veçantë	34
13.1 Sistemi fiskal për pikat e shitjes me pakicë te karburanteve.....	34
13.2 Funksionimi logjik i PEF-it të sistemit fiskal	35
13.3 PEF-i ne sistemin fiskal te karburanteve	35
13.4 Menyja e Raporteve	35
13.5 Leximi i Memories Fiskale.....	35
13.6 Leximi i ditarit elektronik, (nese aplikohet).....	35
13.7 PEF-i ne sistemin fiskal te karburanteve duhet të mundësoj programimin për:	36
13.7.1 Produktet	36
13.7.2 Informatat si:	36
13.7.3 Ndryshimi i normave te TVSH-së.....	36
13.7.4 Mundësitë e sistemeve fiskale	36
13.8 Të mundësoj.....	36
13.8.1 Konfigurimin e tipit te lidhjes Dispenser-KDE	36
13.8.2 Të kryhet aktivizimi i portes pasive te KDE.....	36
13.8.3 Programi softuerik që operon në një PC	36
13.9 Lidhja e dispensereve të karburantit me pajisjen fiskale	37
13.9.1 Të dhënat mbi shitjen e karburantit	37
13.9.2 Kuponi fiskal duhet të përmbajë:.....	37
13.10 Shitjet gjatë testimit dhe kalibrimit te dispenserëve	37
13.11 Puna e stacionit te furnizimit ku është i instaluar sistemi fiskal	37
13.12 Nderprerjet e komunikimit	37
13.12.1 Shkeputja e lidhjes midis KDE dhe qarkut elektronik të dispenserit	38
13.12.2 Shkeputja e lidhjes midis KDE dhe pajisjes fiskale	38
13.12.3 Stacionet e furnizimit qe jane te pajisur me nga vetem nje dispenser	38
13.13 Dispenseri nuk është e lejuar qe të punojë në regjimin manual.....	38
13.14 Riparimi i sistemit fiskal	38
13.15 Pershkrimi i defektit	38
13.16 Në rast mbarimi të letrës ose koka e printerit e hapur	38
13.17 Parametrat teknik te memories fiskale.....	38
13.17.1 Informacioni që duhet të ruhet në memorien fiskale është:	38
ARTIKULLI 14.....	39
Kërkesat për Terminalin Tatimor, te modifikuara për sistemet fiskale për shitjen me pakicë te karburantit.....	39
14.1 Transmetimi i të dhënave	39
14.2 Menyra e komunikimit	39

14.3	Karakteret e transmetuar	39
14.3.1	Emri i fajllit me strukturen ne vijim	39
14.3.2	Fajlli përbëhet nga rreshtat.....	40
14.3.3	Kreu i faqes është një rresht me strukturën si në vijim	40
14.3.4	Raportet ditore duhet të kenë po aq rreshta sa i paraqet raporti ditor.....	40
14.3.5	Raporti ditor per karburante ka ketë strukturë:	40
14.3.6	Qarkullimi sipas dispenserëve ka ketë strukturë:	41
14.3.7	Nderprerjet e komunikimit kanë ketë strukturë:	41
14.3.8	Raporti periodik është një rresht me strukturën si në vijim:	41
14.3.9	Shembulli i raportit te gjeneruar nga sistemi fiskal	Error! Bookmark not defined.

ARTIKULLI 15..... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

Kërkesat Specifike për printerët fiskal.....Error! Bookmark not defined.

15.1 Puna e printerit fiskal

15.2 Testimi i printerit fiskal

SHTOJCA № 2..... 43

Shembuj të kuponit fiskal

Kuponi fiskal për shitje normale

Kuponi me ulje dhe ngritje në përqindje

Kuponi me ulje dhe ngritje në vlera

Kuponi me ulje dhe ngritje në përqindje në nëntotal

Kuponi me ulje dhe ngritje në vlera në nëntotal

SHTOJCA № 3..... 49

Shembull i Raportit Fiskal Ditor

SHTOJCA № 4..... 50

Shembull i raportit periodik te detajuar nga memoria fiskale

SHTOJCA № 5..... 51

Shembull i raportit të shkurtë periodik nga memoria fiskale.....

SHTOJCA № 6..... 53

Shembull i raportit periodik ne sistemin e administrates tatimore permes terminalit tatimor.....

SHTOJCA № 7..... 54

Shembuj të kuponit fiskal per sistemin fiskal shitje me pakicë karburanteve

Raporti Fiskal Ditor “Z”

Raporte te memories fiskale

Raporti fiskal periodik i detajuar.....

Kapitulli 1

I Përgjithshëm

Artikulli 1

1.1 MF

MF do të thotë Ministria e Financave e Republikës së Kosovës

1.2 ATK

ATK do të thotë Administrata Tatimore e Kosovës.

Artikulli 2

2.1 Korniza ligjore

Ky vendim publik lëshohet nën autoritetin e Nenit 9 të Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 03/L-222, të datës 12 korrik 2010.

2.2 Te drejtat e Administrates Tatimore të Kosovës

Neni 13.6 i Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, Nr. 03/L-222, autorizon ATK-në të kërkojë që të gjitha furnizimet e bëra nga të gjithë apo personat të caktuar të tatueshëm të regjistrohen me mjete elektronike dhe të përcaktojë specifikimet e të gjitha llojeve të makinave elektronike që do të përdoren për regjistrimin e tillë. Ligji kërkon që të nxirret një akt nënligjor për zbatimin e këtyre dispozitave. Qeveria e Republikës së Kosovës ka deklaruar dëshirën e saj për të zbatuar arkat fiskale në mbarë Republikën e Kosovës me nxjerrjen e vendimit nr. 02/56 të datës 18 Shkurt 2009. Udhëzimi Administrativ 15/2010 i datës 19/11/2010, neni 21, mbi Përdorimin e Pajisjeve Fiskale në Republikën e Kosovës, kërkon nga Drejtorin Gjeneral të nxjerrë një vendim publik për përcaktimin e specifikimeve teknike të nevojshme për Pajisjet Elektronike Fiskale.

2.3 Qëllimi i këtij vendimi

Ky vendim përcakton kërkesat funksionale e teknike për ta mundur implementimin, duke përfshirë një varg obligimesh dhe rregulla për akteret e ndryshëm, në rend të parë shfrytëzuesit dhe personat dhe stafin e tyre të cilët furnizojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë Pajisjet Elektronike Fiskale (në tekstin e mëtejme quhen PEF).

2.4 Komisioni për licencimin e operatoreve ekonomik

Për qëllim të këtij Vendimi Publik, do të formohet Komisioni për të bërë testimin lidhur me përmbushjen e çdo modeli të Pajisjeve Elektronike Fiskale janë përkufizuar dhe përshkruar më vonë në këtë dokument dhe për t'i certifikuar dhe licencuar ato me qëllim që pajisjet e cekura më lartë të përdoren nga çdo ndërmarrës i obliguar që është definuar me dispozitat e artikullit 3 këtij vendimi, në territorin e Republikës së Kosovës për regjistrimin e sigurt të të dhënave transaksionale, të cilat janë me rëndësi tatimore me qëllim që të sigurohet se të gjithë ndërmarrësit e obliguar raportojnë saktësisht qarkullimin e tyre dhe paguajnë shumën e duhur të tatimit mbi atë qarkullim. Komisioni, kur të jetë e nevojshme, do të bashkëveprojë/kooperojë me të gjitha

departamentet tjera kompetente apo organet përgjegjëse për mbikëqyrjen, monitorimin dhe/ose licencimin e çdo nën-sistemi tjetër elektronik, elektrik apo elektro-mekanik i cili mund të lidhet apo komunikojë me Pajisjet Elektronike Fiskale me qëllim që ti furnizojë ato me të dhënat e nevojshme për funksionim adekuat, me synimin për të formuar gjykimin përfundimtar dhe për të marrë vendimin adekuat për licencimin apo mos-licencimin e një modeli të caktuar të Pajisjes Elektronike Fiskale. Për lëshimin e një licencë të një modeli të Pajisjes Elektronike Fiskale, Komisioni do të marrë në konsiderim kryesisht:

a) nëse një mostër prototip e modelit specifik të Pajisjes Elektronike Fiskale që nga ofertuesi/pala e interesuar është kërkuar ta ketë prodhuar para aplikimit për licencim, i përmbush/përputhet me karakteristikat teknike dhe funksionale të përcaktuara në këtë dokument.

b) nëse pala e interesuar (prodhuesi, importuesi apo shitësi) ka një rrjet mjaft të zhvilluar teknikësh të shërbimit dhe mirëmbajtjes në Kosovë personelin e trajnuar që kërkohet dhe nëse ai mund të ketë në dispozicion sasinë e kërkuar të pjesëve rezervë dhe komponentëve në Kosovë.

c) nëse pala e interesuar (prodhuesi, importuesi apo shitësi) ka aftësi pagimi dhe nëse struktura financiare e biznesit të tij mund të sigurojë një funksionim të qëndrueshëm,

d) nëse, gjatë prodhimit apo gjatë çdo importi, ka mundësi që komisioni të verifikojë që Pajisjet Elektronike Fiskale të importuara përputhen me mostrën prototip të ofruar gjatë procesit të licencimit.

Komisioni ka të drejtë t'i caktojë procedurat e testimit për modelet nën-licencim për institucionet apo organet tjera akademike apo organizatat me njohuritë e duhura dhe pajisjet laboratorike për testim dhe bashkëpunimin me ta për ndonjë çështje të ngjashme ose ndihmë teknike. Institucioni i caktuar apo organi akademik duhet ta përgatisë një raport të posaçëm për Komisionin lidhur me çdo testim të kryer. Koston/shpenzimet e shkaktuara si rezultat i këtyre testeve i bartë pala e interesuar (prodhuesi, importuesi apo shitësi) e Pajisjes Elektronike Fiskale, ose pronari i Pajisjes Elektronike Fiskale të caktuar. Komisioni ka të drejtë ta ekzaminojë të gjitha aspektet që konsiderohen të nevojshëm për marrjen e vendimit të duhur dhe, pas lëshimit të licencës adekuate, të rishikojë nëse detyrimet që rrjedhin nga rastet e sipërpërmendura b, c dhe d përmbushen në të gjitha rastet. Për këtë qëllim, pala e interesuar - aplikuesi (prodhuesi, importuesi apo shitësi) duhet t'i sigurojë Komisionit çdo informatë shtesë që do të kërkohet nga ai. Pala e interesuar - ofertuesi (prodhuesi, importuesi apo shitësi) i një modeli të aprovuar/licencuar të Pajisjes Elektronike Fiskale është i obliguar që të mbështesë me pjesë këmbimi mostrën e aprovuar të tyre për të paktën pesë (5) vite nga fundi i vitit në të cilin është shitur herën e fundit lloji i caktuar i modelit në tregun e Kosovës dhe këtë ta vejë menjëherë në dispozicion për autoritetet tatimore dhe Komisionin kurdo që konsiderohet e nevojshme për qëllime të auditimit. Se si do duhet të vuloset mostra dhe çdo hollësi tjetër e kërkuar, do të përcaktohet përmes një Vendimi të veçantë Publik ose përmes një vendimi të posaçëm të Ministrit.

Artikulli 3

3.1 Autorizimi i modeleve të PEF dhe Terminaleve Tatimore për përdorim në Republikën e Kosovës

Modelet e PEF-ve dhe Terminalet Tatimore për përdorim në Republikën e Kosovës duhet të ndërtohen nga prodhuesi sipas kërkesave Funksionale e Teknike të publikuara në Kapitullin 2 dhe Kapitullin 3 të këtij dokumenti.

Është në kompetencën e Komisionit të formuar nga Ministri i Financave (në tekstin mëtejme të quajtur organi kompetent) që është bërë sipas udhëzimit administrative siç është cekur në artikullin 11 Organi Kompetent, është i autorizuar të aprovojë modele të ndryshme dhe të lëshojë një çertifikatë me numër të regjistruar për modelet e aprovuara. Me qëllim të verifikimit të kontinuitetit dhe përputhshmërisë me verzionin fillestar të çertifikuar këto modele të aprovuara duhet të riçertifikohen nga organi kompetent, çdo 4 vite. Vetëm modelet me çertifikatë të këtillë mund të shiten dhe instalohen në Republikën e Kosovës. Prodhuesit/Importuesit kur të aplikojnë para Organit kompetent për aprovimin e një modeli duhet të sigurojnë një pajisje të atij modeli dhe dokumentet në vijim:

- Doracakun e përdorimit;
- Doracakun e servisimit;

3.2 Testimet për vërtetimin e përputhshmërisë me kërkesat Teknike dhe Funksionale

Testimet për vërtetimin e përputhshmërisë me kërkesat Teknike dhe Funksionale bëhen nga institucioni apo zyrtare akademik ose institucion me njohuri përkatëse dhe pajisje testuese laboratorike me pjesëmarrjen e anëtarit të organit kompetent në mbështetje të prodhuesve/importuesve. “Me mbështetje” nënkuptohet çdo dokumentacion teknik që ka të bëjë me përdorimin e që i nevojitet institucionit akademik (laboratorit). Në fund të testimit Laboratori lëshon protokollin me rezultatet e testimit dhe ia paraqet këtë protokoll organit kompetent.

3.2.1 Për versionet e programit të një modeli të aprovuar bëhen vetëm testimet funksionale

3.2.2 Nëse pajisja fiskale e cila testohet ka pajisje ndërmjetësuese

Nëse pajisja fiskale e cila testohet ka pajisje ndërmjetësuese (interface) për tu lidhur me pajisjen matëse apo sistemet e matjes (P.sh derivatet etj) këto pajisje aprovohen si sistem fiskal. PEF që ben pjese ne nje sistem fiskal për sektorë të veçantë, ka kërkesa të veçanta, të cilat paraqiten me anë të specifikave të posaçme për pikat e shitjes në sektorë të veçantë (për shoqëritë e hidrokarbureve shitësve me shumicë dhe pakicë).

3.2.3 Nëse pajisja fiskale e cila testohet ka ndërfaqe për tu lidhur me pajisjet tjera periferike

Nëse pajisja fiskale e cila testohet ka ndërfaqe për tu lidhur me pajisjet tjera periferike si skanerë bar-kodësh, lexues magneti kartelash etj, këto pajisje periferike nuk guxojnë të ndryshojnë funksionet e pajisjes fiskale. Kjo vërtetohet përmes testimit funksional.

Artikulli 4

Autorizimi i furnitorëve të sistemeve fiskale në Republikën e Kosovës:

Udhëzimi Administrativ lidhur me përdorimin e PEF-ve parasheh që PEF-et dhe sistemet fiskale të instaluar në Kosovë duhet të shiten dhe instalohen përmes një operatori të autorizuar (prodhues, furnitor, distributor dhe agjent). Çdo riparim apo modifikim të një

PEF-i apo sistemi fiskal, duhet të bëhet nga personat e autorizuar për të bërë riparimet apo modifikimet e tilla.

Njohja e furnitorëve të autorizuar dhe dhënia e licencave do të jetë kompetencë e organit kompetent. Udhëzimet praktike do të jepen në një fazë të mëvonshme gjatë punës lidhur me përgatitjen e prezantimit dhe zbatimin e sistemeve fiskale në Kosovë.

Duhet theksuar se njohja e furnitorëve të autorizuar dhe dhënia e licencave është plotësisht e ndryshme nga certifikimi për lejimin e përdorimit të PEF-ve siç do të përshkruhet Kapitull 3 në tekstin e mëtejshëm.

Artikulli 5

Përdorimi i obliguar i pajisjeve të aprovuara të furnizuar dhe instaluar nga furnitorët e licencuar

Transaksionet e shitjes me pakicë apo transaksionet e shitjes me shumicë që bëhen në Kosovë (për të cilat nuk duhet lëshuar kupon nga transferi bankar) në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm, duhet të regjistrohen me pajisjet elektronike fiskale.

Termi PEF përfshinë ato pajisje elektronike si arka fiskale dhe printerë fiskal. PEF apo sistemi fiskal ka si qëllim regjistrojë dhe te transmetoje te dhenat përmes sistemit komunikues mobil të operatorit GPRS deri te sistemi informativ i ATK-se (FTP serverit dhe sistemit te menaxhimit te PEF-eve).

Ato përdoren si pajisje në vete apo të përfshira në sistemet e pikes se shitjes (PSH- POS) dhe sisteme fiskale për lëshimin e kuponëve fiskal në të ardhura (gjithashtu quhen kuponë fiskal të parave të gatshme). Lëshimi i këtillë i kuponëve fiskal nuk varet nga mënyra e pagesës (pagesa në para të gatshme, pagesa përmes kredit kartelave ose përmes instrumenteve ekuivalente të pagesës p.sh përmes çekut etj). Është lejuar që mos të lëshohet kupon fiskal vetëm nëse duhet lëshuar kuponin e paguar përmes transferit bankar. Të dhënat duhet të regjistrohen në mënyrë të njëkohëshme në memorien operative dhe ne ditarin elektronik apo te letres, varesisht se me cilën është e pajisur PEF-i dhe sistemi fiskal, si dhe te printohen ne kuponin fiskal.

PEF-i dhe sistemi fiskal duhet të pajisen me një terminal tatimor të jashtëm apo të integruar (TT). “TT te integruar” nënkupton nje modul të veçantë harduerik te instaluar përbrenda shasisë se PEF dhe qe ndërlihet me moduln kryesor te PEF me anë te kablllove apo konektorëve, apo mund te jetë modul i veçantë harduerik që i përfshinë funksionalitetin e PEF dhe TT ne një firmuer. Qëllimi i këtij terminali është që të transferoj raportet nga memoria fiskale e PEF-it ne sistemin informativ te ATK-se. Totalit e te dhenave te ruajtura ne memorien operative te nje dite ruhen ne memorien fiskale pas mbylljes se raportit fiskal ditor.

Shfrytëzuesit e PEF-it dhe sistemeve fiskale mund të përdorin vetëm pajisje të aprovuara, të furnizuara dhe instaluar nga operatorët e licencuar për të siguruar:

- regjistrimin e plotë dhe korrekt të detajeve të transaksioneve nga PEF-et dhe sistemet fiskale;
- transferin e përmbajtjes së memories fiskale të pajisjeve dhe sistemeve fiskale në sistemin e ATK-së

- për të përjashtuar çdo manipulim të të dhënave gjatë dhe pas regjistrimit të transaksioneve.

5.1 Procesi i obliguar që duhet përmbajtur para fillimit të përdorimit të PEF-ve dhe sistemeve fiskale

Para se një PEF dhe sistem fiskal të instalohet dhe regjistrohet për veprim shfrytëzuesi i PEF-it dhe sistemit fiskal duhet të nënshkruaj një kontratë me shkrim për servisimin dhe riparimin e pajisjes fiskale me kompaninë e cila ka licencë për servisimin e pajisjeve fiskale të modelit të aprovuar. Kompania ngjet etiketën identifikuese në kutinë (shtëpizën) e PEF-it ose të sistemit fiskal.

5.1.1 Forma e etiketës identifikuese në fillim të përdorimit

Shembull i etiketës identifikuese të PEF-it dhe sistemit fiskal:

CE Tensioni 230 V	Operatori Ekonomik	
	Modeli	
	Numri Serik	
	Nr. i Licences nga MF	

5.1.2 Instalimi i PEF-ve dhe sistemeve fiskale para fillimit të regjistrimit të transaksioneve.

Procesi i instalimit të PEF-ve dhe sistemeve fiskale të licencuar bëhet nga furnizuesi i pajisjes. Etiketa e kontrollit periodik (leter ngjithëse vetëshkatërruese) vendoset në pajisje në një vend të dukshëm ku nuk mund të dëmtohet gjatë përdorimit. Një komunikim elektronik i dërgohet Administratës Tatimore para përdorimit të PEF-it dhe sistemit fiskal siç përcaktohet në Paragrafin 2 të Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ mbi përdorimin e PEF-ave në Republikën e Kosovës.

5.2 Kontrolli fillestar ai periodik dhe forma e etiketes se kontrollit periodik.

Ky kontroll vërteton funksionimin korrekt të PEF-it dhe sistemit fiskal.

5.2.1 Kontrolli periodik vjetor

Para fillimit të përdorimit, një etiketë e kontrollit periodik vjetor e cila vërteton regjistrimin e saktë të të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave duhet të vendoset në PEF dhe sistem fiskal e cila tregon datën kur është instaluar ajo dhe instaluesin;

5.2.2 Etiketa e kontrollit periodik vjetor

Më pastaj, duhet bëhet kontroll periodik vjetor, një vit pas datës së fiskalizimit, për t'u siguruar se pajisja funksionon në përputhje me specifikimet, para skadimit të afatit të përcaktuar në nenin 21 të Udhëzimit Administrativ 15/2010, pas datës së fiskalizimit, po jo më herët se 45 ditë para përfundimit të kësaj periudhe.

Nr. □□ □□□□□□□□		
KONTROLLI PERIODIK SKADON		
MUAJI	VITI	MUAJI
1	_____	7
2		8
3		9
4		10
5		11
6		12

- Forma: katrore
- Dimensionet e anësore: ≥ 40 mm
- NGJYRA: Rubrika e gjelbër me shkronja të mëdha ngjyrë të zezë.
- Nënshkrimin PAJISJA ELEKTRONIKE FISKALE do të ceket numri identifikues i PEF-it
- Data e skadimit dd/mm/viti vendoset në mesë të etiketës nën VITI _____.
- Në elipsë do të vendoset vula e teknikut të autorizuar e cila identifikon operatorin ekonomik dhe teknikun përgjegjës për kryerjen e kontrolleve periodike.
- Materiali: Ngjitëse që nuk lejon heqjen pa u dëmtuar gjatë tentimit për heqje.

5.2.3 Dështimi i kryerjes së kontrollit periodik vjetor

Nese PEF ose Sistemi Fiskal nuk e kalon kontrollin periodik vjetor, tekniku i autorizuar duhet ta vendosë etiketën e kontrollit periodik negativ (shiko etiketën në vijim) në një vend të dukshëm mbi pajisje, një letër informuese duhet dërguar në sistemin qendror të Administratës Tatimore të Kosovës dhe organit kompetent. Data dhe koha kur është hequr nga shërbimi PEF-i ose Sistemi fiskal duhet të shënohet në librezën përcjellëse të përshkruar në pike 5.3 në vijim.

PAJISJA ELEKTRONIKE FISKALE
Nr. □□ □□□□□□□□
NUK FUNKSIONON


LOGO

000_

- Forma: katrore
- Dimensionet anësore: ≥ 40 mm
- Ngjyra: Rubrika e kuqe me shkronja të mëdha ngjyrë të zezë, vijëzuar me një diagonale
- Shkronjat: Bold, lartësia 5 mm
- Nën fjalët PAJISJA ELEKTRONIKE FISKALE numri identifikues i PEF-it. Nën shkrimin NUK FUNKSIONON, ne elipsë shenohet vula e cila identifikon operatorin ekonomik dhe teknikun përgjegjës për kryerjen e kontrollit. Materiali: Ngjitëse që lejon heqjen apo dëmtimin gjatë testimit për heqje.

5.3 Libreza speciale përcjellëse

Një librezë speciale përcjellëse duhet të mbahet për secilën pajisje fiskale në të cilën regjistrohen të gjitha ndërprerjet e funksionimit, të gjitha kontrollet, të gjitha mirëmbajtjet/riparimet dhe të gjitha veprimet e tjera të ndërmarra në PEF ose Sistem Fiskal.

Artikulli 6

6.1 Kuponi Fiskal

Kuponi fiskal është dokument në letër i lëshuar nga pajisja fiskale e cila është nga lloji i aprovuar, dhe e cila është e regjistruar zyrtarisht në Administratën Tatimore. Kuponi fiskal është dokument me të cilin regjistrohet shitblerja e mallrave dhe shërbimeve në pikën e shitjes. Kuponi fiskal duhet të ketë se paku 18 karaktere për rresht të printuar dhe duhet të përfundojë me logon fiskale. Logo fiskale është e përcaktuar në Shtojcën №1 në këtë dokument. Përmbajtja në kuponin fiskal përshkruhet në Kapitullin 2. Shembuj të kuponëve fiskal janë dhënë në SHTOJCEN №2.

Artikulli 7

Raporti Fiskal Ditor (RFD)

Raporti fiskal ditor (RFD) është dokument në letër i lëshuar nga pajisja fiskale dhe sistemi fiskal e cila është nga lloji i aprovuar dhe e cila është e regjistruar zyrtarisht në Administratën Tatimore. RFD është dokument në të cilin regjistrohet përmbledhja e shitblerjes së mallrave apo shërbimeve në një pikë të shitjes, pa marrë parasyshë mënyrën e pagesës. Qëllimi kryesor i përmbledhjes është që të dhënat mbi qarkullimin e pergjithshem dhe TVSH-në gjatë ditës të printohen dhe regjistrohen në memorien fiskale, përta i përket PEF-eve.

RFD duhet të mbarojë me logon fiskale. Përmbajtja e RFD-së së PEF-eve është përshkruar në Kapitullin 2. Shembuj të RFD-ve të PEF-eve janë dhënë në **SHTOJCEN №2** në këtë dokument, ndërsa në SHTOJCEN № 7 janë paraqitur shembuj të RFD nga sistemi fiskal për shitje me pakicë të karburanteve.

Modat Shtesë dhe raportet përkatëse të PEF-eve

Përveç modit REGJISTRIMIT (R) çdo PEF duhet të punojë edhe në:

7.1 Modi i leximit të raportit (X)

Çdo PEF duhet të lejojë leximin dhe printimin e të dhënave aktuale të akumuluar gjatë ditës dhe të dhënave të regjistruara në memorien fiskale.

7.2 Modi i Raportit Fiskal Ditor (RFD)

Çdo PEF duhet të lejojë leximin dhe printimin e një përmbledhjeje të të dhënave finale të akumuluar gjatë ditës dhe shkrimin e një përmbledhjeje të këtyre të dhënave në memorien fiskale. Në këtë modë krijohet Raporti Fiskal Ditor (RFD).

7.3 Modi i programimit (P)

Çdo PEF duhet të mundësojë programimin e të dhënave të nevojshme në të. Shumica e të dhënave duhet të programohen vetëm pas Raportit Fiskal Ditor që të bëjë të mundur që raportet e ardhshme të jenë të vlefshme.

Në këtë mod në pajisjen fiskale mund të:

- a) Regjistrohen të dhënat e tatimpaguesit, të cilat duhen të shfaqen në kuponin fiskal. Për këtë funksion programi logjik (FW) duhet të mundësojë regjistrimin në memorien fiskale numrin fiskal të tatimpaguesit, emrin, numrin serik të pajisjes.
- b) Të programojë shkallët tatimore. Me A nënkuptohet shkalla tatimore e përjashtuar, me B shkalla tatimore 16%, ndërsa me germat C-E format e ndryshme të shkallës tatimore të parapara me ligj. Për tatimpaguesit që nuk kanë detyrim pagese të TVSH shkalla tatimore për TVSH në kuponë do të përdoret ajo me 0 (shkronja C), por jo e përjashtuara. Ndryshimi i një shkalle tatimore mund të kryhet vetëm pasi kryhet raporti fiskal ditor si dhe PEF të jetë në modin e servisit, Këto ndryshime regjistrohen në memorien fiskale me një numëror të veçantë për ndryshimet e normave tatimore.

7.4 Modi i transferimit të përmbajtjes së memories fiskale

Në këtë mod PEF-i duhet të ketë mundësinë e transferimit të përmbajtjes së memories fiskale deri në PC.

Gjatë procesit të aprovimit kontrollohet përmes një programi në PC i cili siguron që përmbajtja e memories fiskale është e regjistruar në mënyrë korrekte në një skedar në diskun e PC-se. Përveç kësaj ky program duhet të jap mundësinë që të shihen në monitor të PC përmbajtja e memories fiskale vetëm si e lexueshme.

Nëse për transferimin e përmbajtjes së memories fiskale duhet pajisje harduerike shtese ato duhet të ofrohen nga prodhuesi. Përshkrimet e detajizuara për përdorim funksionit për leximin duhet të jepen në udhëzime.

Tekniku i autorizuar për servisim të PEF-eve është i obliguar që të sigurojë softuer dhe harduer shtese dhe të ofrojë shërbim sa herë që kërkohet nga autoriteti tatimore.

7.5 Të administrojë:

- Artikujt:

- o kodi i artikullit;
- o emërtimet e mallrave apo shërbimeve;
- o çmimi.

- Zbritjet;

- Mënyrat e pagesës;
- Administron grafikët (logon e tatimpaguesit për ta vendosur në kuponin fiskal), (nese pajisja ka kete mundesi);
- Administron portat serike të pajisjes fiskale për programimin e tyre për t'u lidhur me pajisje percjellëse, të tilla, si: bar-kod skaner, peshore, terminal për pagesën me anë te kartelave të kreditit etj.

7.6 Programimi i datës dhe orës

Programi logjik (firmueri) ndalon ndryshimin e datës deri te data e raportit te fundit ditor që është regjistruar në memorien fiskale. Lejon programimin e orës legale brenda kufirit të vetëm +/- një orë, vetëm pasi kryhet mbyllja e Raportit Fiskal Ditor.

7.7 Modet tjera

Çdo PEF duhet te lejojë testimin funksional te tij, duke mundësuar lidhjen me një kompjuter personal apo me pajisje tjetër.

Kapitulli 2

Kërkesat funksionale

Artikulli 8

8.1 Kërkesat e përgjithshme për PEF

Të gjithë PEF-et që përdoren për regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave fiskale elektronike siç janë përcaktor me udhëzimin Administrativ “Mbi përdorimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale në Republikën e Kosovës”, duhet të përmbajnë një memorie punë dhe një memorie fiskale. Të dhënat që duhet regjistruar dhe ruajtur në memorien e punës dhe në memorien fiskale lidhur me mallin e shitur dhe shërbimin e ofruar klientëve, që mundësojnë krijimin e raporteve fiskale në mënyrë automatike siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ të cekur më lartë. PEF-et duhet të kenë një *firmuare (Firmware)* të integruar i cili do të sigurojë sipas këtij dokumenti funksionet e zakonshme për regjistrimin e operacioneve tregtare për shitjen e mallrave dhe shërbimeve, kontrollim të printerit, displejit, tastieres, terminalit tatimor (ne rast te nje moduli harduerik i cili perfshinë funksionalitetit e PEF dhe TT në një firmuer) dhe pajisje tjera periferike. Firmuare-i i integruar duhet të sigurojë funksionet për kontrollimin e regjistrimit të të dhënave në memorien fiskale. Ky firmuare i integruar duhet të ruhet në një memorie të tipit non volatile (memorie e cila ruan shënimet pa pasur furnizim te energjisë elektrike) dhe konstruksioni i PEF-it duhet të garantojë se është e pamundur të fshihet, ndryshohet apo zëvendësohet firmuare-i.

8.2 Raportet

PEF-i duhet të sigurojë raporte ditore, mujore dhe raporte tjera periodike të shitjeve të regjistruara.

8.3 Siguria e te dhenave

PEF duhet të sigurojë mbrojtje të sigurte të të dhënave të ruajtura në memorien fiskale. PEF duhet ta bëjë të pamundur që të dhënat në memorien fiskale të fshihen apo ndryshohen.

8.4 Kontrolli nga zyrtaret tatimore

PEF duhet të sigurojë funksione të cilat do të lejonin zyrtarët tatimor të printojnë të dhënat e ruajtura në memorien fiskale nga tastiera e PEF-it.

8.5 Mbushje e tepërt në modën e regjistrimit

Në rastet kur ndodhë mbushje e tepërt në modën e regjistrimit PEF duhet të bllokohet derisa të printohet një raport fiskal ditor dhe të dhënat e akumuluar të ruhen në memorien fiskale.

8.6 Raportet periodike

PEF duhet të sigurojë funksionet për krijimin e raporteve periodike nga Memoria Fiskale, kur:

- a) Vlera e qarkullimit të akumuluar për secilën nga Grupet e TVSH-së për një periudhë nuk është më e madhe se 199.999.999.999,99
- b) Vlera e qarkullimit total të akumuluar nuk është më e madhe se 199.999.999.999,99;

PEF duhet të sigurojë modën e testimit për të kontrolluar se të gjitha funksionet lidhur me memorien fiskale funksionojnë pa gabime dhe pa probleme. Pajisja do të sigurojë gjithashtu një funksion për printimin e përmbledhjes kontrolluese të firmuare-it të integruar.

8.7 Si sillet PEF kur furnizimi me rryme ndërpritet

Kur furnizimi me rrymë elektrike ndërpritet gjatë funksionimit të PEF-it, funksionimi duhet të vazhdojë automatikisht nga pika ku ishte ndërprerë kur të ri-kyçet furnizimi me rrymë elektrike. Kur furnizimi me rrymë elektrike ndërpritet gjatë printimit, duhet të printohet një rresht special "MUNGESË RRYME" pas rregullimit të furnizimit me rrymë elektrike, rreshti i fundit i printuar duhet të shtypet edhe një herë.

8.8 Valuta e PEF-it

Në modën e regjistrimit PEF do të jetë në gjendje të fillojë punën me çmimet të cilat janë me numër të plotë me dy shifra pas presjes decimale (të llojit 0,00). Valuat në të gjithë PEF e aprovuar duhet të jete Euro- €.

8.9 Shitja apo kthimi i një artikulli

PEF duhet të lejojë shitjen apo kthimin e një artikulli (mallra apo shërbime) apo grupi artikujsh vetëm kur ato të jenë programuar në memorie me një emër dhe një shkronjë për normën përkatëse të TVSH-së.

- a) PEF duhet të sigurojë hapësirë memoruese të mjaftueshme për programimin e së paku 500 artikujve me emrat, çmimet dhe normat e TVSH-së.
- b) Kur artikujt me përcaktim të lirë të çmimeve (të pa-paprogramuar) shiten (çmim i pa programuar) ato automatikisht duhet të caktohen në normën e TVSH-së të artikullit.

8.10 Procedura e kthimit te artikullit te kthyer

Kthimi (rimbursimi) i një artikulli kur të ketë përfunduar kuponi fiskal do të jetë e mundur vetëm nëse artikulli ndërrohet me një artikull të ri i cili ka të njëjtin normë të TVSH-së sikurse edhe artikulli i kthyer. Artikujt e blerë rishtazi duhet të jenë me çmim të njëjtë apo me çmim më të lartë se sa çmimi i artikullit të kthyer. Nëse kjo nuk është e mundur artikulli i kthyer do të jetë i mundur vetëm nëse kthehet kuponi origjinale. Artikulli i kthyer duhet të regjistrohet në një libër të veçantë, “Libri i Furnizimeve të Kthyer”. Përmbajtja e librit “Libri i Furnizimeve të Kthyer” do të përcaktohet nga ATK-ja.

8.11 Normat e TVSH-se

PEF duhet të lejojë llogaritjen automatike të TVSH-së për së paku pese norma të ndryshme të TVSH-së. Çdo normë e TVSH-së shënohet me një shkronjë latine: A, B, C, D, E. Norma e shënuar me shkronjën A është e përjashtuar nga TVSH (Liruar nga TVSH-ja). Përqindja e normave të TVSH-së duhet të programohet dhe ruhet në memorien fiskale para fiskalizimit të PEF-it. Ndryshimi i një shkalle tatimore mund të kryhet vetëm pasi kryhet raporti fiskal ditor si dhe PEF të jetë në modin e servisit nënkupton se vetëm pasi të jetë i ç’plombuar. Këto ndryshime regjistrohen në memorien fiskale me një numrator të veçantë për ndryshimet e shkallës tatimore deri 20 herë. PEF-et për qarkullim për norma të ndryshme të TVSH-së të mallrave të shitura/kthyer nuk mund të kenë vlera negative.

8.12 Data e PEF-it

Kur të futet një ndryshim në datën aktuale të PEF-it ajo do ta kontrollojë nëse data është korrekte. Data e regjistruar nuk mund të jetë më e hershme se sa regjistrimi i fundit në memorien fiskale apo se sa data në të cilën PEF është lëshuar në veprim. Kur të tentohet të regjistrohet një datë më e hershme PEF-i do të bllokohet derisa të regjistrohet data korrekte. Kur data e regjistruar është me një vonesë prej më shumë se një ditë nga data aktuale në PEF, PEF-i do të kërkojë konfirmimin për regjistrim me qëllim të shmangies së gabimeve në të shkruar.

8.13 Njehsoret e PEF-it

Raporti ditor regjistron në memorien fiskale të gjithë njehsorët e PEF-it. Pas raportit fiskal ditor njehsorët e PEF-it duhet të fillojnë të numërojnë prej numrit „1”. Përjashtime bëjnë njehsorët me kërkesa të veçanta. Ato janë përshkruar në këtë dokument. Njehsorët e tillë janë: njehsori për raportet fiskale ditore apo njehsori i dokumenteve të lëshuara nga PEF-i.

8.14 Formati i njehsorit te RFD-ve

Njehsori për raporte fiskale ditore duhet të jenë me së paku 4 shifra decimale.

8.15 Formati i njehsorit te dokumenteve te PEF-it

Njehsori për dokumentet e lëshuara nga PEF-i duhet të jetë me së paku 6 shifra decimale.

8.16 Sjellja e PEF-it ne rast gabimi

PEF-i duhet automatikisht të parandalojë operacionin e mëtejshëm, kur të jetë vërejtur një gabim derisa të evitohet gabimi.

8.17 Raportet e PEF-it

PEF-i duhet të sigurojë të dhëna për raporte ditore, javore, mujore dhe vjetore (raporte periodike) mbi shumat e qarkullimit me TVSH dhe shumat e TVSH-së vetëm për secilën normë të ndryshme të TVSH-së (së paku pesë).

8.18 Funkcionet kontrolluese te PEF-it

PEF duhet të ketë kapacitet, kur gjatë modës së regjistrimit të jenë arritur shifrat maksimale të akumulimit, të bllokojë PEF-in derisa të printohet një raport fiskal ditor dhe derisa të ruhen të dhënat në memorien fiskale. Në rast të tillë, duhet të ketë mundësi të sigurojë dy raporte ditore për të njëjtën ditë.

8.19 Sjellja e PEF-it nëse mekanizmi i printimit është jashtë funksionit

PEF duhet të parandalojë regjistrimin e transaksioneve nëse mekanizmi i printimit është jashtë funksionit ose nëse pajisja ka mbetur pa letër.

8.20 Sjellja e PEF-it nëse memoria fiskale është e ç'kyçur

Nëse memoria fiskale është e ç'kyçur, PEF-i duhet të ndërpres punën e tij, duhet të bëjë "PASTRIMIN E MEMORIES" dhe të kalojë në "GJENDJËN FILLESTARE". PEF-i pastaj duhet të parandalojë veprimin e mëtejshëm. Pas kyçjes së memories fiskale PEF-i duhet të restaurojë të dhënat e tij për tu përshtatur përmbajtjes së memories fiskale. Në këtë rast kërkohej ndërhyrja e teknikut të autorizuar.

8.21 Furnizimi tjetër me rrymë elektrike

PEF-i duhet të ketë bateri që rimbushen apo furnizim tjetër me rrymë elektrike në rast të ndërprerjes së rrymës elektrike. Kur furnizimi me rrymë elektrike është i ndërprerë gjatë veprimit të PEF-it, veprimi duhet të vazhdojë automatikisht nga momenti kur është ndërprerë furnizimi me rrymë elektrike gjatë printimit, duhet të printohet një rresht special "MUNGESË RRYME" pas rregullimit të furnizimit me rrymë elektrike, rreshti i fundit i printuar duhet të printohet edhe një herë.

8.22 Printimi i të dhënave nga zyrtarët e autorizuar tatimor

Duhet të jetë e mundur që zyrtarët e autorizuar tatimor të printojnë të dhënat e ruajtura në memorien fiskale.

8.23 Printimi i raportit fiskal ditor nëse nuk ka ndodhur asnjë transaksion

Çdo PEF duhet të krijojë një Raport Fiskal Ditor, edhe nëse nuk ka ndodhur asnjë transaksion dhe totalët ditore janë zero.

8.24 PEF i pajisur me një ditar elektronik

Nëse implementohet një ditar elektronik çdo informate e shkruar në këtë ditar duhet të përcillet me lexim automatik të kontrollit dhe konfirmimin se të dhënat janë ruajtur në mënyrë korrekte. Nëse të dhënat në ditarin elektronik janë të korrupsionuara PEF duhet të bllokojë modën e regjistrimit.

8.25 Parametri i shumë gjuhësisë

PEF-i duhet të ketë një parametër për shumë gjuhësi. Ky parametër duhet të ketë 3 gjendje në varshmëri nga kjo gjendje PEF-i duhet të punojë në gjuhën shqipe, serbe apo angleze. Duhet të mundësohet që gjendja e këtij parametri të mund të ndërrohet pas çdo kuponit fiskal dhe pas çdo raporti. Mesazhet e PEF-it, emrat e artikujve fjalët në kokën dhe fundin (header-footer) e kuponit duhet të ndryshohen në varshmëri nga ky

parametër. Shkronja e alfabetit duhet të jenë shkronja latine duke përfshirë edhe karakteret e veçanta të gjuhës shqipe, serbe dhe angleze.

Artikulli 9

Kërkesat për memorie fiskale

9.1 Moduli i veçantë

Ndërtimi i PEF duhet të përfshijë një modul të veçantë të quajtur Memorie Fiskale. Ky modul duhet të mbyllet si një modul dhe duhet të mbyllet në konstruksionin (shtëpizën) e PEF-it. Moduli do të sigurojë hapësirë memorie të tipit non volatile (memorie e cila ruan shënimet pa pasur furnizim të energjisë elektrike) të të dhënave të ruajtura në të për jo më pak se 10 vite. Prodhuesi/Importuesi është i obliguar të sigurojë programe softuer-ike për rigjenerimin e informatave të ruajtura në këtë modul.

9.2 Kapaciteti i memories fiskale

Kapaciteti i memories fiskale do të jetë i mjaftueshëm për të ruajtur së paku 1850 raporte fiskale ditore. Raportet fiskale ditore duhet të kenë strukturë të fiksuar. Kur numri i raporteve fiskale ditore të mbetura në memorien fiskale është i barabartë me apo më pak se 50 atëherë në secilin Raport Fiskal Ditor i PEF duhet të printojë informacion rreth numrit të raporteve fiskale ditore të mbetura për të cilat ka vend të lirë në memorien fiskale. PEF do të ndalojë ndonjë veprim të mëtutjeshëm kur nuk ka më kapacitet ruajtës.

9.3 Informatat që regjistrohen në memorien fiskale para fillimit të punës

PEF duhet të futet në punë vetëm pasi informacioni në vijim të jetë i programuar në memorien e saj fiskale:

- a) ID numri (Numri Fiskal) i tatimpaguesit (13 karaktere)
- b) Numri serik i PEF (dy karaktere për identifikimin e operatorin e licencuar, dy shifra që identifikojnë tipin e PEF-it të licencuar dhe 6 shifra të numrit serik të pajisjes).
- c) Data, ora dhe minuti kur PEF është vënë në veprim.

Duhet të jetë e pamundshme të ndryshohen informatat e mësipërme gjatë përdorimit të PEF-it.

9.4 Të dhënat që ruhen në memorien fiskale

Të dhënat në vijim të lidhura me raportet fiskale ditore, raporte periodike dhe informacion për datën e fillimit të veprimit do të ruhen në memorien fiskale:

- a) Numri i raportit fiskal ditore (XXXX - 4 shifra);
- b) Data e raportit fiskal ditore (XX XX XX - 6 shifra), në formatin dd mm vv;
- c) Nga raporti fiskal ditore qarkullimi i shitjeve ditore për së paku 5 norma të tvsh-se deri në 19999999,99;

- d) Nga raporti fiskal ditor vlera e tatimit ditor për secilën normë të TVSH-së. Vlera maksimale i tatimit për secilën normë të TVSH-së duhet t'i përgjigjet vlerës maksimale të shitjeve ditore për secilën normë të TVSH-së;
- e) Nga Raporti Fiskal Ditor numri i kuponëve fiskal të lëshuara në modën e regjistrimit;
- f) Mesazh për humbje të qarkullimit për shkak të Ndërprerjes së Memories;
- g) Normat e TVSH-së dhe ndryshimet e tyre;
- h) Vendi i presjes decimale në çmimin e artikullit dhe në regjistrin e tij (historiku);
- i) Data, ora, dhe minutat kur PEF është fiskalizuar.

9.5 Nderprerja e funksionimit te memories operative

Kur qarkullimi ditor është fshirë apo humbë nga memoria e PEF për shkak të mosfunksionimit, PEF duhet të shkruaj në memorien fiskale regjistrin me informata mbi datën, orën dhe minutat e procesit të rigjenerimit. Ajo gjithashtu e numëron këtë ngjarje me ngritjen e një njehsori të veçantë për dështime të memories. Gjatë printimit të raportit fiskal ditor PEF duhet të printojë “NDËRPRERJE E MEMORIES”, NJEHSORI XXXX, dd, hh, mm”

9.6 Struktura dhe kontrolli mbi informatat e regjistruara ne memorien fiskale

Çdo e dhënë që është ruajtur në memorien fiskale duhet të ketë strukturë blloku të fiksuar që përmbanë një shumë kontrolluese për bllokun. Shuma kontrolluese garanton se të dhënat në bllok nuk kanë ndryshuar. Çdo regjistrim në memorien fiskale përcjellët me një lexim dhe konfirmim se të dhënat janë ruajtur në mënyrë korrekte. Nëse gjendet ndonjë gabim në të dhënat PEF duhet të bllokojë modën e regjistrimit.

Artikulli 10

Kërkesat e PEF për paraqitjen e të dhënave dhe printim

10.1 Mekanizmi i printimit

PEF-i do të ketë një mekanizëm printimi alfa-numerik i cili lejon njëkohësisht printimin e një kuponi për konsumator dhe një kopje të kuponit në ditar. Informacioni i printuar në modën e regjistrimit dhe në raportin fiskal ditor gjithmonë do të printohet në të dy letrat.

10.2 Format e ditarit elektronik

Lejohet që informata për ditarë që krijohet njëkohësisht me atë të konsumatorit të ruhet në një memorie të tipit non volatile (FLASH apo EEPROM). Kjo memorie do të lejojë ruajtjen e së paku 2000 rreshtave. Ky ditar elektronik printohet në një modë të ndryshme nga moda e regjistrimit si “ditar elektronik me printim të vonuar”. Në këtë rast lejohen dy opsione:

10.2.1 Ditari elektronik siguron hapësirë për më pak se 100 000 rreshta

Kur ditari elektronik siguron hapësirë për më pak se 100 000 rreshta për shtypje, në këtë memorie do të ketë qasje vetëm pas heqjes së vulës fiskale të PEF dhe atë:

- a. Ditari do të printohet automatikisht para çdo raporti fiskal ditor dhe të dhënat në memorien e ditarit do të fshihen pas printimit. Ditari lejohet të printohet në pjesë të ndara me numra me vendimin e operatorit. Ai duhet të printohet gjithmonë kur ekziston stërngarkimi i mes-memories (buffer memory) së ditarit. Numri i ditarit duhet të përmbajë numrin e raportit ditor fiskal të cilit i përket dhe numrin ngritës (incremental) të pjesës së printuar të ditarit;
- b. Nëse ditari nuk printohet si duhet, printimi i raportit fiskal ditor do të bllokohet;
- c. Nëse mbesin me pak se 50 rreshta në memorien e ditarit procesi i krijimit të kuponit të ri do të ndërprehet dhe duhet ta paraqes mesazhin për përfundim të ditarit. Kur të mbeten vetëm 10 rreshta në memorien e ditarit do të paraqitet mesazhi i njëjtit dhe kuponi fiskal do të mbyllet automatikisht.
- d. Kur memoria e ditarit është e mbushur PEF duhet të bllokohet derisa ditari të printohet në mënyrë të suksesshme. Memoria e ditarit nuk mund të pastrohet derisa llogaria të printohet në mënyrë të suksesshme;
- e. Numërimi i pjesëve të printuara të ditarit për secilin raport fiskal ditor duhet të printohen në krye të raportit fiskal ditor;

10.2.2 Ditari elektronik siguron hapësirë më tepër se 100 000 rreshta

Kur ditari elektronik lejon më tepër se 100 000 rreshta të printimit që të ruhen, ky modul mund të jetë i dizajnuar enkas (liber elektronik) apo SD kartelë standarde.

Nëse ky modul është i dizajnuar enkas (liber elektronik), atëherë ai mund të jetë i heqshëm (përdoruesi të ketë qasje). Ky lloj i memories duhet të dizajnohet si modul i veçantë që mund të hiqet (pa pasur nevojë të dëmtohet vula fiskale) për ruajtjen e kopjes elektronike të ditarit elektronik. Ky modul nuk do të lejojë asnjë ndryshim në të dhënat tanimë të ruajtura. Ditari për çdo raport fiskal ditor mund të printohet nëse operatori e dëshiron këtë. Pas printimit ditari nuk fshihet. Kjo mundëson që ditari elektronik të printohet në çdo kohë kur kjo është e nevojshme duke zgjedhur numrin e raportit fiskal ditor apo datën e tij. Në këtë rast çdo kupon fiskal do të përmbajë numrin e raportit fiskal ditor në të cilin përfshihet dhe numrin e tij në të. Me këtë lloj të ditarit PEF-i mund të siguroj një printim të veçantë për:

- çdo kupon fiskal
- çdo raport fiskal ditor
- raporte periodike për periudha të caktuara
- numrat e raporteve fiskale ditore të para dhe të fundit të ruajtur në ditarin elektronik

Ne mungesë të ditarit elektronik PEF-i nuk do të funksionojë.

Nëse ky modul është SD kartelë standarde, atëherë përdoruesit nuk bën të kenë qasje në kartelë dhe kartela duhet të jetë e mbrojtur me vulën fiskale të PEF. Në këtë rast SD kartela mund të jetë modul i ndarë i lidhur me modulën kryesor të PEF me anë të kabllove apo konektorëve elektrik ose mund të jetë pjesë e modulit harduerik i inkorporuar në funksionalitetin e PEF-it. Megjithatë, SD kartela duhet të jetë e mbrojtur nga: ndryshimi, fshirja etj, duke implementuar mekanizma të mbrojtjes në dispozicion për SD kartelë standarde.

- a. Ditari elektronik i cili futet si një modul i zbrazët në PEF sinkronizohet me shenimet nga PEF në të cilin kyçet. Futja do të bëhet pas printimit të një raportit fiskal ditor dhe para lëshimit të kuponit të parë fiskal në modën e regjistrimit.

Gjatë shkrimit të parë të PEF-it në ditar, ai do të sinkronizoj punën e tij me PEF-in dhe të bëhet modul aktual i tij. Ditari do të vazhdoj të jetë aktual deri sa PEF-i të shkruaj qarkullimin në një ditar tjetër elektronik të zbrazët. Në këtë rast moduli i vjetër do të shërbejë vetëm për leximin e informatave të tij nga ai PEF, vetëm në modin e leximit.

- b. Në rastin e modulit të dizajnuar enkas, kur mbeten më pak se 50 rreshta në memorien e ditarit elektronik duke filluar nga kuponi i ri memoria do të bllokojë regjistrimin. Kur mbesin 10 rreshta në memorie, kuponi fiskal duhet të mbyllet automatikisht.

Në rastin e SD karteles standarde, kur mbesin më pak se 500 rreshta në memorie, fillimi i kuponit të ri duhet të bllokohet apo nëqoftë se është ndonjë kupon i hapur atëherë kuponi do të mbyllet automatikisht.

10.3 Limiti minimal i karaktereve në një dokument të printuar

Çdo dokument i printuar nga PEF-i do të ketë së paku 18 karaktere për rreshtin e printimit në letrën e gjerë së paku 28 mm dhe ai duhet të përmbajë:

- a. Kreun e dokumentit me:
 - Jo më pak se 150 karaktere (rreshtat e zbrazët nuk printohen) që përdoren për:
 - Emrin, adresën e tatimpaguesit;
 - Emrin dhe adresën e shitores dhe kur nuk ka shitore tekstin “shitje ambulante”;
 - Të dhëna tjera të nevojshme;
 - Numrin fiskal të tatimpaguesit;
 - Numrin e certifikatës së TVSH-se, nëse është në TVSH;
 - Në rrjetin e shitores numrin lokal të PEF-it (së paku 2 shifra) dhe vetëm për kuponin fiskal emrin e operatorit dhe numrin e operatorit;
- b. Fundin e dokumentit me:
 - Numrin rritës (inkremental) të dokumentit;
 - Datën, orën dhe minutat e lëshimit;
 - Numrin identifikues të PEF-it.
 - Derisa të fiskalizohet PEF-i ai do të printoj në çdo dokument tekstin “KUPON JO FISKAL”.
 - Kur të fiskalizohet PEF-i ai do të printoj në rreshtin e fundit të kuponit të konsumatorit, në rreshtin e fundit të raporteve fiskale ditore dhe në rreshtin e fundit të të gjitha raporteve nga memoria fiskale tekstin “KUPON FISKAL” dhe pas kësaj në rreshtin tjetër logon fiskale. Në të gjitha dokumentet tjera do të printohet teksti “KUPON JO FISKAL”. Kur të jetë e nevojshme lejohet që të printojë vetëm një kopje të kuponit fiskal. Në këtë rast kjo kopje do të shënohet si “KOPJE” printuar me font me gjerësi të dyfishtë. Kopja është kupon jo fiskal.

10.4 Printimi i kuponit fiskal

Çdo PEF duhet të ketë mundësinë të printoj kuponin fiskal për furnizimet e bëra te çdo klienti. Kuponi fiskal lëshohet në dy kopje. E para si kupon i konsumatorit dhe e dyta si kopje e ditarit. Kuponi fiskal duhet të jetë i lexueshem dhe duhet të përmbajë të dhënat si në vijim:

- Kreun e kuponit;
- ID e PEF-it se paku 2 shifra ne raste se janë instaluar me shume se një PEF ne një lokacion;
- Emri i operatorit dhe numri i tij;
- Numri sekuencial (rendor) i kuponit të lëshuar;
- Data dhe koha e transaksionit;
- Se paku një rresht për secilin artikull, sasinë shumëzuar me çmimin për njësi, emrin e artikullit apo shërbimit apo shkurtesën e tij, vlerën e sasisë së furnizimit dhe normën e TVSH-së të shënuar me një shkronjë specifike për çdo artikull të furnizuar. Kur sasia është një ka mundësi që të mos paraqitet edhe sasia dhe çmimi;
- Përqindjen (apo vlerën) e zbritjes dhe shumën e saj me shenjën minus apo përqindjen (apo vlerën) e rritjes nëse ka per artikull;
- Shumën e nën-totalit, përqindjen (apo vlerën) e zbritjes mbi të dhe shumën e saj me shenjën minus përqindjen (apo vlerën) tepricë nëse ka;
- Shumën totale për pagesë;
- Shumat e paguara në mënyra të ndryshme;
- Shumat e tatimit sipas normave të ndryshme aktive tatimore;
- Shumat totale pa tatim;
- Fundin e kuponit.

Ndërmjet rreshtit me tekstin “KUPON FISKAL” dhe logos fiskale printohet një numër rritës i kuponit fiskal të konsumatorit/klientit të lëshuara gjatë ditës.

Shembuj të kuponëve fiskal janë dhënë në **SHTOJCEN № 2**.

10.5 Raporti Fiskal Ditor

Raporti fiskal ditor duhet të përmbajë:

- Kreun e dokumentit;
- Emrin e raportit dhe numrin e tij;
- Pjesën e parë të raportit
 - njehsimin e konsumatorëve (kuponët fiskal)
 - shumën totale të regjistruar në “sirtarin” e PEF-it
 - njehsimin dhe shumën e ngritjes se çmimeve
 - njehsimin dhe shumën e zbritjese se çmimeve
 - shumën totale neto të qarkullimit duke përfshirë TVSH-në
 - njehsimin e kthimeve (rimbursimeve) dhe shumën totale të rimbursimeve
 - njehsimin e korrigjimeve (anulimeve) dhe shumën totale të anulimeve
 - llojin e pagesës dhe shumën për çdo lloj të pagesës
 - shumën totale neto në para të gatshme të qarkullimit duke përfshirë TVSH-në
 - shumën e pranuar të parave të gatshme (nga menaxheri)
 - shumën e paguar në para të gatshme (te menaxheri)
 - shumën totale të parave të gatshme në sirtar.
 - Pjesen e dytë te raportit
 - Norma A e TVSH-së perjashtuar nga TVSH-ja

- Qarkullimi total për normë shuma
- Norma B e TVSH-së --%
- Qarkullimi pa TVSH shuma
- TVSH shuma
- Qarkullimi total për normë shuma
- Norma C e TVSH-së --%
- Qarkullimi pa TVSH shuma
- TVSH shuma
- Qarkullimi total për normë shuma

.....

përsëritje për të gjitha normat aktive të TVSH-së

.....

- shuma totale e qarkullimit pa TVSH
 - shuma totale e tatimit (TVSH) që duhet paguar
 - shuma totale e qarkullimit duke përfshirë TVSH-në
 - njehsimi i kuponëve fiskal
 - njehsimi i dështimeve në memorie
 - shuma totale e akumuluar e qarkullimit duke përfshirë TVSH-në për PEF që nga fiskalizimi;
 - shuma totale e akumuluar e tatimit (TVSH) që duhet paguar për PEF që nga fiskalizimi.
- Pjesa 3 e raportit
 - Teksti “PEF i fshire”
 - Numri i Raportit Fiskal Ditor në memorien fiskale
 - Njehsimi i Raporteve Fiskale Ditore të zbrazëta në memorien fiskale
 - Fundi i dokumentit

Shembulli i Raportit Fiskal Ditor është dhënë në **SHTOJCE № 3**.

10.6 Raporti i detajuar periodik

Shtypja e raportit të detajuar periodik nga memoria fiskale do të përfshijë:

- Kreun e dokumentit
- Emrin e raportit
 - numri i fillimit të datës së periodës
 - numri i fundit të datës së periodës
 - datën, orën dhe minutat e fiskalizimit
- Pjesa e parë e raportit përmbanë:
 - numrin rendor të normës përkatëse të TVSH-së dhe numrin e RFD
 - datën, orën dhe minutat kur janë regjistruar normat e TVSH-së
 - pozicionin e pikës decimale

- të gjitha normat aktive të TVSH-së dhe vlerat e tyre.

- Pjesa e dytë e raportit
 - numrin rendor dhe datën e RFD
 - njehsimin e kuponëve fiskal
 - qarkullimin sipas normës A të TVSH-së të liruar nga TVSH-ja shuma
 - qarkullimi sipas normës B të TVSH-së shuma
 -
 - përsërit për të gjitha normat aktive të TVSH-së
 -
 - tatimin (TVSH) që duhet paguar sipas normës B të TVSH-së shuma
 -
 - përsërit për të gjitha normat aktive të TVSH-së
 -
 - shumën totale të qarkullimit duke përfshirë TVSH-në për RFD
 - shumën totale të tatimit (TVSH) që duhet paguar për RFD
 -
 - përsërit pjesën 2 për të gjitha RFD-të me këto norma të TVSH-së në periudë.
 -
 - përsërit pjesët 1 dhe 2 për të gjitha normat e TVSH-së nëse normat e TVSH-së kanë ndryshuar në periudë
 -

- Pjesa e tretë e raportit
 - njehsimin e Raporteve Fiskale Ditore në periudë
 - shumën totale të qarkullimit duke përfshirë TVSH-në për periudë
 - shumën totale të tatimit (TVSH) që duhet paguar për periudë
 - njehsimin e kuponëve fiskal në periudë
 - qarkullimin sipas normës A të TVSH-së liruar nga TVSH-ja shuma
 - qarkullimin sipas normës B të TVSH-së shuma
 -
 - përsërit për të gjitha normat aktive të TVSH-së në periudë
 -
 - tatimin (TVSH) që duhet paguar sipas normës B të TVSH-së shuma
 -
 - përsërit për të gjitha normat aktive të TVSH-së në periudë

.....

- Fundin e dokumentit

Shembulli i raportit të detajuar periodik nga memoria fiskale është dhënë në **SHTOJCE № 4**

10.7 Raporti i shkurtë periodik

Printimi i një raportit të shkurtër do të përfshijë:

- Kreun e dokumentit
- Emrin e raportit
 - numrin e fillimit të periodës;
 - numrin e fundit të periodës;
 - datën, orën dhe minutat e fiskalizimit;
- Pjesa e parë e raportit:
 - njehsimin e Raporteve Fiskale Ditore në periodë
 - shumën totale të qarkullimit duke përfshirë TVSH-së për periodë
 - shumën totale të tatimit (TVSH) që duhet paguar për periodë
 - njehsimin e kuponëve fiskal në periodë
 - qarkullimin sipas normës A të TVSH-së të liruar nga TVSH-ja shuma
 - qarkullimin sipas normës B të TVSH-së shuma
 -
 - përsëritet për të gjitha normat aktive të TVSH-së në periodë
 -
 - tatimin (TVSH) që duhet paguar sipas normës B të TVSH-se shuma
 -
 - përsëritet për të gjitha normat aktive të TVSH-së në periodë
 -
- Fundi i dokumentit

Shembulli i raportit të detajuar periodik nga memoria fiskale është dhënë në **SHTOJCEN №5**.

10.8 Raporti periodik qe transmetohet ne sistemin e ATK-së

Në një mod të veçantë PEF-i do të sigurojë mundësinë të dërgojë një raport periodik në serverin e Administratës Tatimore përmes Terminalit TATIMOR. Kërkesat për këtë raport periodik janë përshkruar në Artikullin 11 të këtyre kërkesave

funkionale. Transmetimi i suksesshëm i këtij raporti do të përfundoj më printimin automatik të përmbledhjes së tij i cili do të përmbajë:

- Kreun e dokumentit
- Emrin e raportit
 - datën e fillimit të periodës
 - datën e përfundimit të periodës
 - datën, orën dhe minutat e fiskalizimit.

- Pjesa e parë të raportit
 - njehsimin e Raporteve Fiskale Ditore në periodë
 - shumën totale të qarkullimit duke përfshirë TVSH-në për periodë
 - shumën totale të tatimit (TVSH) që duhet paguar për periodë
 - njehsimin e kuponëve fiskal në periodë
 - qarkullimin sipas normës A të TVSH-së të liruar nga TVSH shuma
 - qarkullimin sipas normës B të TVSH-së shuma
 -
 - përsëritet për të gjitha normat aktive të TVSH-së në periodë
 -
 - tatimin (TVSH) që duhet paguar sipas normës B të TVSH-së shuma
 -
 - përsëritet për të gjitha normat aktive të TVSH-së në periodë
 -

- Kodi 32-bit

- Teksti “Transmetimi OK” nëse transmetimi është kryer me sukses apo teksti “Transmetimi jo OK” nëse transmetimi nuk është kryer me sukses.

- Fundi i dokumentit.

Shembulli i raportit të printuar nga PEF-i pas transmetimit të suksesshëm të raportit periodik në serverin e ATK-së (përmes Terminalit TATIMOR) është dhënë në **Shtojcën № 6**.

10.9 Valuta e dokumentit

Të gjitha shumat e regjistruara apo të akumuluar shprehen në EUR apo CENT.

10.10 Kërkesat që do t’iu përmbahet PEF-i

PEF-at do t’iu përmbahen këtyre kërkesave. Lejohet që të printohen më shumë informata nëse kjo do të shtonte funksionalitetin dhe shoqërimin e shfrytëzuesit të PEF-it. Lejohet që të mos printohen disa parametra kur vlera e tyre është zero dhe dokumenti është i lexueshëm. Kur të printohet një raport i artikujve është e domosdoshme të printohet karakteri i caktuar i normës së TVSH-së.

10.11 Printimi i të dhënave

10.11.1 Karakteristikat e letres termike per PEF-in dhe sistemin fiskal

Printimi i të dhënave duhet të kryhet në shiritin (letrën) e pajisjes elektronike fiskale e cila ruan të dhënat së paku për 5 vjet sipas kriterëve të ruajtjes së informacionit për letrat termike dhe që ka këto karakteristika:

- normën e bardhësisë 85 % (të matur nga ELEPONI-m-UNI-7623/86);
- shkallën e butësisë 30 ml/s (BENDSTEN-UNI-7626/I/II/86);
- letër bazë Ph>7.

10.11.2 Verifikimi i standardit të letres termike

Operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë pranë organit kompetent çertifikatat e letrës termike sipas këtyre standardeve. Organi kompetent do të verifikojë përputhjen e karakteristikave të letres dhe të njëjten do ta çertifikojë për përdorim në PEF dhe sisteme fiskale.

ARTIKULLI 11

Kërkesat për Terminalin Tatimor (TT) për PEF-et e zakonshëm

11.1 Gadishmëria për të pranuar të dhënat

PEF-i apo Terminali Tatimor duhet të tregojë se terminali TATIMOR është i gatshëm për të pranuar të dhëna.

11.2 Transmetimi i të dhënave

Terminali TATIMOR duhet të pranojë raportet periodike nga memoria fiskale të cilat krijohen nga PEF-i dhe përgaditen për tu dërguar në serverin e ATK-se. Protokollin e transmetimit do të garantojë që raporti është pranuar në mënyrë korrekte në serverin e ATK-së. Në fund të raportit të transmetimit duhet të paraqitet një shumë kontrolluese 128 bit-she e kalkuluar mbi raportin e dërguar sipas algoritmit MD5 (standard 1321). Shuma e njëjtë kontrolluese duhet të printohet nga PEF-i në raportin përmbledhës pasi raporti i transmetuar të jetë pranuar në mënyrë të sukseshme në serverin e ATK-se. Ky raport përmbledhës duhet të mbahet bashkë me raportet fiskale ditore. Do të ketë mundësi të printohet raporti i njëjtit përmbledhës. Gjithmone raporti i njëjtit të dërgohet në serverin e ATK-se.

11.3 Menyra e komunikimit

Komunikimi duhet të bëhet përmes sistemit GPRS, që duhet bazuar në protokollin TCP/IP. Dosjet me raportet do të transmetohen në një FTP server. Terminali TATIMOR duhet të konfigurohet me një program CONFIG. Programi duhet të përdoret për të shënuar në terminal parametrat e serverit FTP (emrin, ID, Fjalëkalimin) dhe PIKËN E QASJES mobile të GPRS operatorit. Detyra e nënkuptuar për çdo shfrytëzues të PEF-it është që të transmetojë një herë në muaj (para datës 10) raport mujor.

Data dhe koha përcaktohen nga shfrytëzuesi.—Karakteret e transmetuar në dosjen (fajllin) i cili transferohet në serverin e ATK-se janë në kodin ASCII. Struktura e emrit të fajllit dhe struktura e fajllit do të jenë si në vijim:

Emri i fajllit me strukturën në vijim

iiiiiiiiii_ddmmyyyy_DDMMYYYY_ddmmyyyyhhmm .txt ku:

iiiiiiiiii është numër identifikimi i PEF
ddmmyyyy është data e fillimit te periudhës
DDMMYYYY është data e përfundimit te periudhës ddmmyyyhhmm është data,
muaj, viti, ora dhe minutë kur është krijuar raporti nga PEF.
Një shembull: AB02000048_01082008_31082008_050920081643.txt

Emri i fajllit është për raportin e krijuar nga PEF AB02000048 për periudhën Gusht
2008. Ai është krijuar më 05.09.2008, ora 16, minuta 43.
Fajlli përbëhet nga rreshtat, mbarojnë me "LF" +"CR". Përmbajtja e secilit rresht
është e shenjëzuar me karakterin e tij fillestar. Karakteret e përdorura janë:

- H – kreu i faqes i raportit;
- D – Raporti Ditor, në radhë ngritëse;
- E – Raporti i Gabimit Ditor, Rivënia e Memories së PEF;
- P – Raport periodik;
- S – Përmbledhje;
- C – Shuma kontrolluese sipas MD5.

Kreu i faqes është një rresht me strukturën si në vijim

H iiiiiiiiii kkkkkkkkkkkkkk ddmmyyyy DDMMYYYY Ku:

kkkkkkkkkkkk është numri i ID i taksapaguesit

Rreshti doti ketë 5 parametra të ndarë me “hapësirë”.

Raportet ditore duhet të kenë po aq rreshta sa i paraqet raporti ditore. Secili rresht do të ketë strukturën e njëjtë:

D a b c d e apo E a b c d e

Secili rresht do ti ketë 20 parametra të ndarë me “hapësirë”.

ku:

a- DFR numri (ZZZZ)

b- dita, muaji, viti, ora dhe minuta e raportit ditore

c- numri i kuponit të konsumatorit fiskal i përfshirë në raport

d- qarkullimi (duke përfshirë TVSH-në) për secilin grup tatimor e- shumat e TVSH-së për secilin grup tatimor

Nëse gjatë ditës ka dështim të memories (RAM) rreshti i raportit ditore do të jetë:

E 0 b 0.

Raporti periodik është një rresht me strukturën si në vijim: P l m n o

Rreshti do ti ketë 19 parametra të ndarë me “hapësirë”. ku:

l- numri i raporteve fiskale ditore të përfshirë në periudhë m- numri i kuponëve fiskal për periudhën.

n- qarkullimi total (duke përfshirë TVSH-në) për secilin grup tatimor për periudhën.

o- shumat totale të TVSH-së për secilin grup tatimor për periudhën.

Raporti i përmbledhjes është një rresht me strukturën si në vijim: S l m p q

Rreshti do ti ketë 5 parametra të ndarë me “hapësirë”. Ku:

p- qarkullimi total (duke përfshirë TVSH-në) për periudhën;q- shumat totale të TVSH-së për periudhën.Një shembull i një raporti nga memoria fiskale që është dërguar nga Terminali Tatimor në serverin e Administratës Tatimore.

Një shembull i përmbajtjes së fajllit:

```
H iiiiiiiiii kkkkkkkkkkkkkk ddmmyyyy DDMMYYYY      (kreu i faqës)  D   1234
ddmmyyyhhmm 43 0 10000 1000 0 0 0 0 0 0 200 100 0 0 0 0 0 (DFR1)      D   1235
ddmmyyyhhmm 52 0 100000 10000 0 0 0 0 0 2000 1000 0 0 0 0 0 (DFR2)
```

.....

```
D 1248 ddmmyyyhhmm 12 0 1000 100 0 0 0 0 0 20 10 0 0 0 0 0 (DFR15) P 15 752
0 1000000 100000 0 0 0 0 0 0 200000 10000 0 0 0 0 0 (Prpt) S 15 752 1100000
210000
```

Nëse ka PRESJE DECIMALE, shuma transferohet me presje decimale në vendin e duhur (ashtu si është printuar në raportin e PEF).

KAPITULLI 3

Kerkesat teknike per PEF-et e zakonshem dhe Terminalet Tatimore

ARTIKULLI 12

Kërkesat Teknike Themelore

12.1 Tipi i memories fiskale te PEF-it

PEF-at duhet të kenë memorie fiskale të tipit non volatile (memorie e cila ruan shënimet pa pasur furnizim te energjisë elektrike), që nuk fshihet.

12.2 Kohëzgjatja e përdorimit aktiv të PEF-it dhe TT

PEF-at dhe Terminalet Tatimore duhet të jenë të përshtatshme për te funksionuar deri ne 24 orë ne dite.

12.3 Ora e kohës reale

PEF-at duhet të kenë orë të kohës reale që mund të mbajë kohën e saktë për së paku 1500 orë pa furnizim me rrymë elektrike nga jashtë.

12.4 Sigurimi i të dhënave pa furnizim

PEF duhet te siguroj te dhëna e regjistruara ne memorien non volatile (me bateri rezerve) pa burim te energjisë nga jashtë deri më se paku 1500 ore.

12.5 Mekanizmi i printimit

PEF-at duhet të kenë mekanizëm printimi alfa-numerik me letër kupon dhe libër elektronik apo vetëm letër kuponi kur përdoret libri elektronik. Kur mbaron letra PEF duhet të bllokohet.

12.6 Ekрани i operatorit dhe konsumatorit

PEF-at duhet të kenë ekran alfa-numerik për operatorin dhe konsumatorin me së paku 16 karaktere.

12.7 Indikatorët e TT

Terminali Tatimor i jashtëm duhet të ketë indikatorë të cilët i tregojnë operatorit në cilën fazë të veprimit gjendet terminali për momentin.

12.8 Kapaciteti i memories per artikujt

PEF-at duhet të kenë memorie për artikujt me kapacitet për:

- programimin e së paku 500 artikujve me emrat, çmimet dhe normën e TVSH- së

së tyre;

- regjistra akumulativ për sasinë e shitur dhe qarkullimin e secilit artikull të shitur;

12.9 Kushtet e punës së PEF-it

PEF-at duhet të jenë në gjendje të operojnë në temperaturat prej 0 deri 40°C. PEF-at që do të përdoren në ambient të hapur duhet të jenë në gjendje të operojnë prej minus 15 deri në plus 45°C.

12.10 Montimi i memories fiskale

Memoria fiskale duhet të montohet në një modul të ndarë me mure jo-transparente të ngurtë, që në mënyrë permanente shenjëzohet me numrin e tij individual. Moduli i memories fiskale duhet të mbyllet si modul dhe moduli duhet të mbyllet në kutinë e PEF.

12.11 Mbyllja e PEF-it

PEF duhet të sigurojë mbyllës të veçantë (zakonisht një ngjites apo ndonjë mjet tjetër) për të ruajtur memorien e programit nga ndryshimet apo fshirja.

12.12 Sigurimi i seteve të veçanta

PEF duhet të sigurojë sete të veçanta të regjistrave akumulativ për secilën normë të TVSH-së për kuponin dhe për çdo normë të TVSH-së për tërë ditën (për periudhën kohore të raportit fiskal ditor).

12.13 Rexhistrat akumulativ

Regjistrat akumulativ për kuponët fiskal duhet të jenë së paku 8 (tetë) shifror.

12.14 Ndertimi i PEF-it

Ndërtimi i PEF dhe Terminalit Tatimor duhet të dizajnohet në asi mënyre që të ketë vulë që shihet, e cila do të garantonte se vetëm serviseret e autorizuar mund të kenë qasje në komponentët elektrike dhe në module. Vula vendoset apo largohet nga tekniku i autorizuar i servisit.

12.15 Nderlidhja (interface) për lidhje me PC

PEF dhe Terminali Tatimor duhet të kenë së paku një ndërfaqe (ndërlidhje – interface) për lidhje në PC.

12.16 Bateria Akumuluese

PEF duhet të ketë të inkuorporuar bateri që rimbushen ashtu që të ketë mundësi të punojë së paku dy orë edhe nëse PEF nuk është i kyçur në ndonjë pajisje furnizuese (UPS).

12.17 Tensioni alternativ furnizues

PEF-i duhet të jete dizajnuar të punojë në tension alternativ një fazore të rrjetit publik me parametrat si në vijim:

- Tensioni: 230V ± 10 %
- Frekuence: 50 ± 1 Hz

Ka mundësi që PEF të funksionon me Tension njëkahorë (DC) me të vogël se 30 V nëse është i pajisur me adapter të tensionit AC në DC të kyçur në rrjetin publik të energjisë elektrike.

Implementimi i furnizimit me energji elektrike duhet te jete ne pajtueshmëri me Rregullativen Evropiane. Gjithashtu PEF duhet te jete i dizajnuar për nga pikëpamja e sigurisë ne pajtueshmëri te plote me Standardet Evropiane aktuale.

12.18 **Kërkesat Teknike**

Kërkesat teknike për PEF dhe Terminalet Tatimore për EMC, ESD, vibrime, intervale temperature, siguri etj. duhet të vërtetohen me një Deklaratë të lëshuar nga prodhuesi/importuesi. LABORATORI mund të kërkojë dokumente dhe deklarata shtesë.

ARTIKULLI 13

Sistemi fiskal për pika te shitjes në sektorë të veçantë

13.1 **Sistemi fiskal për pikat e shitjes me pakicë te karburanteve**

Sistemi fiskal për regjistrimin e qarkullimit të shitjes me pakicë të karburanteve (stacionet e naftës, gazit) mund te jetë zgjidhje softuerike apo harduerike, perderisa i ploteson te gjitha karakteristikat funksionale dhe teknike te specifikuara me dokument dhe te jete i çertifikuar nga organi kompetent.

Me dispenser (shpërndarës) nënkuptojmë një pompë apo një stacion furnizimi me karburant në të cilin janë instaluar disa pistoleta furnizimi për lloje të ndryshme karburantesh dhe që komandohen me një qark (kokë) elektronike.

Në një pikë shitjeje (stacion furnizimi) mund të jenë instaluar një apo disa dispenserë. Lidhja duhet të jetë, një KDE (Kontroller i Dispenserit Elektronik) për një ose me shume dispenserë. Në stacionin e furnizimit të gjithë dispenseret e karburantit, përfshirë dhe ata të GPL (lëndet djegëse te lëngëta dhe të gazta) duhet të punojnë nën regjimin e sistemit fiskal. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet dispenserit dhe sistemit fiskal bëhet në bazë të një protokollit te komunikimit-ndërlidhës, kompatibil me specifikat e dispenserit të karburantit. Përdorimi i mekanizmave te tjerë e që kanë ndërlidhje te mundshme me KDE në ndonjë menyre apo tjetër, përpos me anë te protokollit te komunikimit-ndërlidhës është absolutisht e ndaluar. Furnizimi me karburant duhet të jetë i lidhur saktësisht me regjistrimin e shitjeve dhe duhet të punojë nën rregullin e detyrueshëm "PA KUPON FISKAL, S'KA KARBURANT". KDE e lidhur në qarkun elektronik të dispenserit siguron transferimin e informacionit në pajisjen fiskale për shitjet e realizuara dhe komandon proceset e punës së dispenserit. Sistemi fiskal harduerik është një zgjidhje e mëvetshme (stand alone) e përmbledhur në nje kuti e cila mund të vendoset në ambientin e hapur, pranë dispenserit, për këtë zgjidhje operatori ekonomik ose prodhuesi duhet të deklaroj që ky sistem si tërësi i përmbanë këto karakteristika:

- Temperaturë të ambientit - 30°C / +55 °C;
- Lagështia 5 % - 95 %;
- Duhet të plotesoj standardet CE dhe ATEX;
